



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

01 Nr. 447 / 2023
31.05.2023

KRYETARI / PREDSIEDNIK / MAYOR

<https://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/ 200 438 14

NJOFTIM

Në bazë të neni 68, paragrafi 3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe në bazë të nenit 4 paragrafi 1, neni 6 paragrafi 1 pika 1.3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna si dhe Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, Kryetari i Komunës së Istogut në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim Publik organizon:

DËGJIM PUBLIK

për

KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE – KAB 2024-2026

Të nderuar qytetarë të Komunës së Istogut, ju ftojmë që të merrni pjesë në Dëgjimin Publik për: **Kornizën Afatmesme Buxhetore – KAB 2024-2026.**

Dëgjimi Publik do të mbahet me datë **19 Qershor 2023** duke filluar nga ora **11:00**, në **sallën e Kuvendit të Komunës së Istogut.**

Ky Dëgjim Publik, organizohet nga Kryetari i Komunës së Istogut në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim Publik.

Me qëllim që qytetarët të njihen rreth këtij dokumenti, Komuna e Istogut, konkretisht Zyra për Informim ka publikuar njoftimin dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore – KAB 2024-2026 në ueb faqen zyrtare të Komunës së Istogut, <https://kk.rks-gov.net/istog/category/degjimetbuxhetore/> në rubrikën Dëgjimet Buxhetore.

Këto diskutime publike janë të hapur për të gjithë qytetarët e Istogut, duke përfshirë shoqërinë civile, profesionistët dhe ekspertët e fushave relevante, andaj ftoheni të gjithë pa dallim të merrni pjesë në Diskutim Publik.

Kryetari i Komunës

z. Ilir FERATI

